



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 143, datë 28.09.2023

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË AKORDUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.506, DATË 30.08.2023 “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.514, DATË 18.09.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS-KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të nenit 7 të Ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Vendimit nr.514, datë 18.09.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyerjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese” të ndryshuar, Vendimit nr.506, datë 30.08.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në Vendimin nr.514, datë 18.09.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyerjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendor”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 892.511.312,6 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e pesëqind njëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtë) lekë pa TVSH të përfituar në zbatim të Vendimit nr. 506, datë 30.08.2023 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në Vendimin nr.514, datë 18.09.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyerjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese” të ndryshuar, sipas tabelës së mëposhtme:


Grupi	Kap.	Programi	Art.	Kod produkti	Kod institucioni	Institucioni	Objekti	Fondi viti 2023 (në lekë)
00	1	04960	231	94902AE	2107001	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit	883,940,719.27
00	1	04960	231	94902AE	2107001	Bashkia Durrës	Mbikëqyrje	7,876,755.59
00	1	04960	231	94902AE	2107001	Bashkia Durrës	Kolaudim	693,837.74
00	1	04960	231	94902AE	2107001	Bashkia Durrës	TOTAL	892,511,312.6

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi

U shpall sot me datë 29.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 629/Prot.

Durrës, më 05.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.143 datë 28.09.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të akorduar në zbatim të vendimit të këshillit të ministrave nr.506, datë 30.08.2023 “Për një shtesë në vendimin nr.514, datë 18.09.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”, të ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

